



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

---

**AD/GJTHPR/12/24**

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga E.B ndaj gjyqtares V.N.H, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 02.07.2024 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e ushtruar nga E.B ndaj gjyqtares V.N.H për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Pala E.B me datë 11.06.2024 ka paraqitur kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares V.N.H me pretendimet për shkelje të ligjit gjatë gjykimit në rastin PS.nr.4/22, ku me datë 13.06.2024 lidhur me ankesën është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Parashtruesi i ankesës në ankesën e tij ka deklaruar se gjyqtarja V.N.H, duke ushtruar detyrën e Kryetares së trupit gjykues në lëndën PS.nr. 4/22 jo vetëm që nuk e ka zbatuar nenin 7 par. 2 të KPPK-së, i cili e detyron që me ndërgjegje dhe përkushtim maksimal të vërtetoj faktet provat fajësuese dhe shfajësuese, por në arsyetimin e vendimit ka shtrembëruar dhe manipuluar me provat personale dhe materiale duke shkelur detyrimin e saj edhe sipas nenit 5 të KPPK-së, me elemente të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Sipas ankuesit, gjyqtarja ka shkelur detyrat e gjyqtarit sipas nenit 5 par.2 pika 2.7 të Ligjit nr. 06/L-057, pasi që gjykata ka dështuar që të kujdeset për rregullsinë e procesverbalit të seancës së shqyrtimit gjyqësor edhe pse e kishte detyrë sipas nenit 313 par.1 të Kodit të Procedurës Penale dhe ka refuzuar pa ndonjë arsyetim përfshirjen e vërejtjeve dhe kërkesave për korrigjim të procesverbalit sipas kërkesave të arsyetuara të mbrojtjes. Sipas tij, procesverbali i seancës së datës 06.02.2023 ishte dërguar 58 ditë nga përfundimi i seancës dhe i njëjti përmban parregullsi substanciale të cilat konsistojnë në mos përfshirje të pyetjeve të parashtruara nga i akuzuari E.B dhe të përgjigjeve të dëshmitarit si dhe përshkrim të gabuar si të pyetjeve ashtu edhe të përgjigjeve dhe mos përfshirje të pyetjeve të palejuara nga gjykata. Tutje ka deklaruar se gjykata i ka mohuar të drejtën e përdorimit të provave materiale gjatë dhënies së dëshmisë së dëshmitarëve në seancën e datës 06.02.2023, gjatë dhënies së dëshmisë së dëshmitarit A.K.

Sipas tij, në këtë seancë mbrojtja ka paraqitur disa prova materiale të cilat KTGJ ka kërkuar që këto prova të dorëzohen si pjesë e plotësimit të provave gjatë fazës së paraqitjes së provave nga mbrojtja, në kundërshtim me nenin 332 të KPPRK-së. Këto prova janë paraqitur si prova materiale të dhëna në shikim dëshmitarit, , disa prej tyre prova të prokurorisë, por jo të gjitha që ndërlidhen me pyetjet e parashtruara nga i akuzuari, ndërsa në procesverbalin e datës 03.04.2023, nuk është shënuar fare se dëshmitari është ballafaquar me këto prova. Sipas tij, provat ( të cilat janë renditur në ankesë) i janë paraqitur dëshmitarit A.K me lejen e KTGJ në seancës e datës 06.02.2023 por që nuk janë evidentuar fare në procesverbal. Sipas tij, me mos përfshirjen e saktë të përmbajtjes së kësaj seance, arsyetimi i aktgjykimi nuk ka përfshirë faktet dhe provat e dorëzuara nga mbrojtja në atë seancë me të cilat ishte atakuar kredibiliteti i dëshmitarit dhe sidomos pretendimi për vuajtje të pasojave nga ky dëshmitar për shkak të veprimeve të tij të cilat i lidh me të akuzuarit. Tutje ka deklaruar se procesverbali i seancës së datës 30.03.2023 në të cilin ishte dëgjuar dëshmitarit R. Q ishte dërguar 20 ditë nga përfundimi i seancës, ku i njëjti përmban parregullsi substanciale të cilat konsistojnë në mos përfshirje të pyetje të parashtruara nga i akuzuari E.B dhe të përgjigjeve të dëshmitarit si dhe përshkrim të gabuar si të pyetjeve ashtu edhe të përgjigjeve dhe mos përfshirje të pyetjeve të palejuara nga gjykata. Sipas tij, mbrojtja kishte dorëzuar vërejtjet e saj me shkrim me parashtrësën e datës 19.05.2023 por gjykata nuk ia ka përfshirë si shtojcë të procesverbalit.

Tutje, ankuesi ka deklaruar se me parashtrësën e datës 31.03.2023, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij e kanë tërhequr nënshkrimin në procesverbalin e datë 06.02.2023, faqja e fundit e të cilit ishte dhënë për nënshkrim menjëherë pas përfundimit të seancës, ndërsa përmbajtja e plotë vetëm pas 58 ditësh, ku sipas tij i akuzuari E.B i ka nënshkruar të gjitha procesverbalet e seancave të shqyrtimit gjyqësor me vërejtje, ndërsa nënshkrimi i tij në këto procesverbale nuk nënkupton pranimin dhe pajtimin e tij me përmbajtjen e tyre. Sipas tij, në seancën e datës 030.4.2023 gjatë dhënies së dëshmisë së A.R, mbrojtja ka kërkuar që kjo dëshmitare të ballafaqohet me procesverbalin e takimeve të KDNM të dt. 31.05.2018 dhe vazhdimësinë e tij të 01.06.2018 në të cilin theksohet se kjo dëshmitare, sikurse të gjithë anëtarët e tjerë të KDNM e kishte pranuar opinionin ligjor të Ministrisë së Infrastrukturës të kërkuar me dt. 31.05.2018, ndërsa gjatë dëshmisë në shqyrtim gjyqësor e kishte mohuar pranimin e këtij dokumenti. Ankuesi ka deklaruar ndër të tjerash se edhe këtë procesverbal e ka pranuar pas 17 ditësh, pas kërkesës së mbrojtjes, ku edhe i njëjti përmban shkelje substanciale dhe të cilat konsistojnë në mos përfshirje të pyetjeve të parashtruara na i akuzuari E.B dhe përgjigjeve të dëshmitarit si dhe përshkrim të gabuar si të pyetjeve ashtu edhe të përgjigjeve, si dhe mos përfshirje të pyetjeve të palejuara nga gjykata.

Tutje, ndër të tjerash ka deklaruar se gjyqtarja ka bërë shkelje të detyrave të gjyqtarit të cilat parashihen me nenin 5 par. 2 pika 2.1 të Ligjit nr. 06/L-057, ku ka bërë keqinterpretim të provave personale dhe materiale, pasi që në seancën e dt. 04.12.2023 në faqen 11 të këtij procesverbali përshkruhet dëshmia e G.P, por që në arsyetimin e Aktgjykimit të gjykatës në f. 60 kjo pjesë e deklaratës është keqinterpretuar nga gjyqtarja e çështjes.

Tutje, ankuesi ka renditur në mënyrë të detajuar provat materiale të cilat sipas tij gjykata i ka anashkaluar ose ka vepruar në kundërshtim me obligimin e saj sipas nenit 7.par. 2 të KPPK-së për të vlerësuar provat fajësuese dhe ato shfajësuese, siç është shkresa elektronike e datë 28.12.2017 nga dëshmitarit R.Q për të pandehurin B, shkresa e kompanisë mbikëqyrëse Hill International dt. 09.08.2018, procesverbali i KDNM i dt. 01.06.2018, si dhe administrimin si

provë materiale të statutit të KDNM edhe pse nuk e ka vërtetuar hyrjen në fuqi të këtij dokumenti – vlefshmërinë ligjore.

Sipas ankuesit, gjykata jo vetëm që nuk i ka trajtuar të gjitha provat me ndërgjegje dhe me kujdes siç e obligon neni 360 par. 2 të KPPK-së, por me mungesë të hapur të paanshmërisë në kundërshtim me nenin 5 të KPPK-së e ka vënë para aktit të kryer të akuzuarit. Tutje, ka renditur dëshmitë e dëshmitarëve dhe për fund ka deklaruar se në bazë të gjitha të lartcekurave gjyqtarja e çështjes ka shkelur nenin 7 par. 2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit gjykata është e obliguar që të ekzaminoj me ndërgjegje dhe përkushtim si provat fajësueses ashtu edhe ato shfajësuese dhe ka vepruar në kundërshtim me detyrimin e saj për paanshmëri sipas neni 5 të KPPK-së, e që ka rezultuar me nxjerrjen e vendimit në shkelje të neni 360 par. 2 të KPPK-së. Andaj, sipas tij duke pasur parasysh se shkelja e ligjit konsiderohet shkelje disiplinore sipas neni 5 par. 2 pika 2.1 dhe 2.7 të Ligjit nr. 06/L-057, në këtë rast gjyqtarja V.N.H ka vepruar në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e saj.

Gjyqtarja e rastit në lidhje me ankesën e parashtruar ka deklaruar se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Special me datë 31.01.2024, ka shpall Aktgjykimin në çështjen penale kundër të pandehurit E.B etj, ku i pandehuri E.B është shpallur fajtor dhe është dënuar sipas ligjit, ku e njëjta lëndë është në procedim me ankesa kundër Aktgjykimit në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Lidhur me pretendimin e të pandehurit E.B, se në cilësi të KTGJ gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor në çështje penale PS.nr.4/22, gjyqtarja e çështjes ka shkelur rregullat e KPP-së konkretisht nenet 7, 2 dhe 5, sipas gjyqtarës ky pretendim nuk qëndron pasi që pasi shikimit dhe vlerësimit të procesverbaleve në këtë çështje penale, gjatë procedurë penale janë zbatuar rregullat e lartcekura, andaj i njëjti lidhur me këto konstatime ka të drejtë ankese kundër vendimit përfundimtarë-Aktgjykimit, këtë të drejtë edhe e ka ushtruar.

Tutje, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar pretendimet e të pandehurit E.B se ka pas parregullsi në procesverbalet e seancave të shqyrtimit gjyqësor të datave 06.02.2023 dhe 03.04.2023, kur është dëgjuar dëshmitari A.K, si dhe nuk janë evidentuar provat e prezantuar në këto seanca për marrjen në pyetje të dëshmitarit A.K, si dhe ka pas parregullsi në procesverbalin e seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 03.04.2023, ku është dëgjuar dëshmitarja A.R, si dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datë 29.09.2023, kur është dëgjuar dëshmitari L.ZH, të njëjtat pretendime i ka vlerësuar dhe shqyrtuar në procesverbalet e seancave pasuese sipas vërejtjeve të të pandehurit E.B të paraqitura me anë të parashtrësve për procesverbalet e seancave të datave të lartcekura, dhe pas vlerësimit të tyre ka marr Aktvendimet për secilën vërejtje, të cilat Aktvendime mund të atakohen nga i pandehurit E.B dhe mbrojtësi i tij kundër vendimit përfundimtarë-Aktgjykimit, të cilën të drejtë sipas gjyqtare palën e kanë ushtruar, ndërsa ka deklaruar se sa i përket provave materiale të propozuara në këtë procese gjyqësor, siç dihet propozimi për prova të reja bëhet tek faza e prezantimit të provave materiale nga palët në procedure, e jo në fazën e dëgjimit të dëshmitareve siç pretendon i pandehuri E.B.

Ndërsa sa i përket pretendimeve për dërgimin e procesverbaleve të lartcekura me vonesë, gjyqtarja ka deklaruar se të pandehurit E.B ju ka nevojitur kohë në interval kohor prej një 1 viti e 4 katër muaj nga mbajtja e seancës dhe afërsish 6 muaj nga shpallja e aktgjykimit të paraqes këto vërejtje për vonesa në dërgimin e procesverbaleve, mirëpo këto pretendime të i ka konsideruar të pa bazuara, pasi që sipas gjyqtare së çështjes i njëjtit me çdo kush gjatë këtij procesi gjyqësor ka bërë përpjekje në evidentimin e ndonjë shkelje procedurale, me qëllim që

nëse është e nevojshme ti atakoj me ankesë kundër vendimit përfundimtarë.

Tutje ka deklaruar se pretendimet e të pandehurit E.B të cekura në faqe 1, 2 dhe 3 të kësaj ankese, se në cilësi të KTGJ ka bërë shkeljes e rregullave të nenit 7, 2 dhe 5, i të KPP, si dhe me Aktvendimet e marra në procesverbalet e kësaj çështje penale në lidhje me vërejtje e bëra nga i pandehuri E.B në procesverbalet e seancave të lartcekura, të gjitha këto pretendime për shkelje procedurale mundë ti atakoj me ankesë kundër vendimit përfundimtarë-Aktgjykimit.

Ndërsa, lidhur me pretendimet e të pandehurit E.B të paraqitura në ankesë të cekura në faqe 4 e deri në faqe 15, me titull “Ndryshimi i dëshmimeve të dëshmitareve” si dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar në këtë çështje penale si: B.A, G.P, R.Q, B.H, A.R, V.LL, A.Z, ku dëshmitë e tyre janë deponuar dhe vlerësuar në Aktgjykimin PS.nr.4/2022, të datës 31.01.2024, si dhe vlerësimi i disa provave materiale të vlerësuar në aktgjykimin e lartcekur, gjyqtarja ka deklaruar se këto pretendime të pandehurit E.B duhen të adresohen me ankesë kundër Aktgjykimi për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, e as një herë të mos adresohen nga i pandehuri si manipulim dhe shtrembërime me prova materiale dhe personale në këtë çështje penale, pasi që sipas vlerësimit të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve të lartcekur kanë qenë dëshmi relevante në këtë çështje penale, dhe janë të njëjta me dëshmitë e tyre të dhëna në fazat e më hershme të kësaj çështje penale, andaj pretendimet e të pandehurit E.B janë tërësisht të pa bazuar, pasi që tani kemi një aktgjykim ku të njëjtit pretendime si në këtë ankesë i ka atakua vet dhe mbrojtësi i tij edhe me ankesë kundër aktgjykimit, pasi që është zgjidhja e vetme sa i përket pretendimeve të lartcekura nga i pandehurit E.B, pasi që i njëjtit në këtë ankesë ju ka referuar Aktvendimeve procedurale të shqyrtimit gjyqësor dhe përmbajtës së dëshmimeve të dëshmitarëve dhe provave materiale të cekura në aktgjykimin e kësaj çështje penale.

Tutje ka deklaruar se sa i përket pretendimit për shkelja e detyrave të gjyqtarit nga Ligji nr.06/L-057 , Neni 5 Shkeljet disiplinore për gjyqtarë par 2. Shkelje e detyrave të gjyqtarit, sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se gjyqtari i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë: 2.1. kryen detyra zyrtare duke mos respektuar parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore duke vepruar me paragjyqime në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal të palës në procedurë; 2.7. në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare me kohë, siç kërkohet me ligj, vlerësohet se në këtë ankesë janë konstatuar dispozitat e ligjit të lartcekur pa një arsytim mbështetës, pa shpjegim, pa vlerësim dhe pa analizë të situatës konkret brenda pikës 2.1 dhe pikës 2.7, të pa mbështetur në provë konkrete, andaj gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se në mungesë së arsyes dhe rrethanave sqaruese, pretendimet e të pandehurit E.B janë të pa bazuar.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës V.N.H.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të

cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Autoriteti kompetent ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjitha pretendimet e paraqitura nga ankuesi, në referim të shkeljes disiplinore e cilat parashihet me nenin 5 par. 2 pika 2.7 të Ligjit Nr. 06/L-057, e që ka të bëjë me mos kryerjen e detyrave zyrtare me kohë siç kërkohet me ligj, ku ankuesi këtë pretendim e ka mbështetur me faktin se procesverbalet e seancave gjyqësore i janë dërguar me vonesë, si dhe me parregullsi substanciale.

Në bazë të shkresave të lëndës, shihet se gjyqtarja e çështjes ka konstatuar në procesverbal të gjitha vërejtjet e parashtruara nga ana e palëve ashtu siç parashihet me nenin 204 të KPPRK-së. Autoriteti kompetent vë në pah se nuk është e përcaktuar asnjë afat ligjor a po gjyqësor në lidhje me dërgimin e procesverbaleve tek palët, ndërsa praktika e dërgimit të procesverbaleve tek palët pas përfundimit të seancave gjyqësore është krijuar si nevojë e vet gjykatës dhe palëve me qëllim që procesverbali të mos mbaj gabime drejtshkrimore a po teknike. Kjo do të thotë, se palët kanë të drejtën e përcaktimit të kohës adekuate për dërgimin e procesverbalit dhe të kërkojnë nga gjyqtarja e çështjes dërgimin e procesverbalit deri në një datë të caktuar. Pra, fakti se nuk ka një kohë të caktuar ligjore a po gjyqësore të përcaktuar dhe palët nuk kanë shprehur asnjë pakënaqësi në këtë drejtim, kjo nuk mund të konsiderohet se gjyqtarja e çështjes nuk i ka kryer detyrat e saj me kohë dhe siç kërkohet ligji.

Andaj, nëse në këtë rast gjyqtarja e çështjes ka konstatuar në procesverbal vërejtjet e palëve në procedurë, si dhe në shkresat e lëndës ekzistojnë edhe parashtresat në lidhje me kundërshtimin e këtyre procesverbaleve, kjo i jep të drejtën palës që këto pretendime ti paraqesë para gjykatës së shkallës së dytë me rastin e ankimimit ndaj Aktgjykimit përfundimtar, të cilën të drejtë edhe e ka shfrytëzuar. Gjykata e Apelit si shkallë e dytë është kompetente që të shqyrtoj sipas detyrës zyrtare nëse ekzistojnë shkelje të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 paragrafit 1 të këtij Kodi ose nëse është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit se gjyqtarja e çështjes ka shkelur ligjin nr.06/L-057, rrjedhimisht nenin 5 par. 2 pika 2.1, që ka të bëjë me kryerjen e detyrave zyrtare duke mos respektuar e parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore duke vepruar me paragjykimë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë në rastin konkret pas shqyrtimit të dosjes dhe shkresave të lëndës nuk ka arritur të provojë pretendimet e palës ankuese, pasi që në këtë drejtim parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova për të argumentuar se si rezultat i cilave fakte ka arritur të konstatoj se gjyqtari ka shkelur pavarësinë e tij, a po është treguar i njëanshëm, a po çfarë sjellje është manifestuar nga gjyqtari i rastit e cila bie ndesh me Kodin e Etikës për gjyqtarë apo veprime të cilat hyjnë në domenin disiplinor.

Vërtetimet a po vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë në dëm a po në dobi të palës akuzuese a po palës së dëmtuar, nuk mund të jenë arsye për inicim të procedurës disiplinore për gjyqtarin, a po të pretendohet se gjyqtarja e çështjes është treguar e paanshme a po ka shkelur parimin e pavarësisë, kjo sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjisllacionit në fuqi.

Pretendimet për keqinterpretim të provave personale dhe materiale, a po konstatime të gabuara të deklaratave të palëve në aktgjykimin përfundimtar, nuk mund të jenë arsye për inicim të procedurës disiplinore për gjyqtaren e çështjes, kjo pasi që Autoriteti Kompetent – Kryetarja e Gjykatës nuk ka kompetencë të vlerësoj a po të komentoj vendimet gjyqësore, kjo kompetencë i takon vetëm gjykatës së shkallës së dytë, që të vlerësoj nëse si rezultat i shkeljeve procedurale a po materiale të bëra nga gjykata e shkallës së parë është bërë konstatim i gabuar i gjendjes faktike a po është shkelur ligji në dëm të të akuzuarit.

Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë”, e po ashtu parimi i njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare ku në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, ku parashihet: "Gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit”.

Andaj, Autoriteti Kompetent ka vlerësuar se aplikimi i gabuar dhe jo i drejtë i te drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtareve gjatë punës se tyre, mund të jete shkak për ushtrimin e ankesës nga ana e palës se pakënaqur ne Gjykatën e instancës me te lartë, e qe kjo çështje lidhet me aspektin profesional te gjyqtarit dhe e njëjta mund te shërbej si kriter ne vlerësimin e performancës se gjyqtarit te caktuar, por jo te konsiderohet shkelje disiplinore nga ana e të njëjtit.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/12/24, me datë 02.07.2024

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë